



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Administrim Biznes”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luarasi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alba Skëndaj

2. PhD Eriona Shtëmbari

Nëntor/ 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznes” ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë Universiteti “Luarasi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Luarasi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim Biznesi
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Administrim Biznes”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 483, datë 12.10.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 144, date 16.04.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 434, datë 25.08.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (2022- 2023)	16 PAE/ 11 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021: 53 studentë 2021-2022: 74 studentë 2022-2023: 39 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në "Administrim Biznes" (AB) është hapur në vitin 2012, sipas Urdhërit Nr. 483, datë 12.10.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për hapjen e disa programeve të reja të studimit të ciklit të parë dhe të dytë pranë Shkollës së Lartë Private "Luarasi", si pjesë e programeve të studimit që ofrohen nga Departamenti Administrim Biznesit (DAB), Fakulteti Ekonomisë (FE). (Rref. Evidenca 6 Urdhër MAS për Hapje Programi Bachelor në "Administrim Biznes" (AB).

Programi i studimit të Ciklit të parë BAB është akredituar në vitin 2015 me Vendim Nr. 94, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë bazuar në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë". Pasuar me Urdhërin Nr. 23, datë 19.01.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për akreditimin me kusht të Programit të studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Administrim Biznes", bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".(Ref. Evidenca 63 Vendim i KAAL Nr. 94, dt. 02.11.2015 Per Akreditimin me kusht të Programit BAB; Evidenca 64 Urdhër MAS Nr. 23, dt. 19.01.2016 Per Akreditimin e Programit BAB).

Kushtet u konsideruan të plotësuara në bazë të Vendimit Nr. 184, datë 07.07.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Programi i studimit të Ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznes" ka vijuar me akreditimin bazuar në Urdhërin e MAS Nr.432, datë 25.08.2016,. (Ref. Evidenca 65 Urdhër MAS Nr. 432, dt. 25.08.2016 "Per Plotesimin e Kushteve per Akreditimin e Programit BAB").

Programi studimit të Ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznes" i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është program me kohë të plotë, me 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatje normale tre vite akademike.

Programi i studimit të Ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznes" është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në mbështetje të Vendimit nr.41, datë 24.01.2018 Programi BAB është organizuara në Veprimtaritë formuese sipas kategorive nga A në E, me lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese, dhe detyrimet përmbyllëse, të përcaktuara në Planin mësimor të BAB.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr., datë janë:

Programi i studimit të Ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznes" është akredituar në vitin 2015 me Vendim Nr. 94, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë bazuar në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë". Pasuar me Urdhërin Nr. 23, datë 19.01.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit për akreditimin me kusht të Programit të studimit të të Ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznes", bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Për sa më sipër KAAL dha vlerësim pozitiv me kushte, duke rekomanduar:

- Rritjen e stafit akademik efektiv për një shpërndarje më të mirë në numër dhe cilësi të lëndëve/disiplinave që atambulojnë.
- Rrishikimin e stafit të departamentit të ekonomisë, pasi një pjesë e mirë e tyre nuk kanë formimin e duhur në fushën përkatëse të studimit (ekonomiksit)
- Të rriten kapacitetet e bibliotekës për të mbajtur një nr më të madh studentësh dhe pasurimi i titujve të literaturës së këtij program

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Bazuar në RVB dhe Vendimit Nr. 182, datë 07.07.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, UL plotësoi kushtet e rekomanduara brenda një periudhe 6 mujore, duke ju drejtuar KAAL me raport për plotësimin e kushteve.

Bazuar në Urdhërin e MAS Nr.434, datë 25.08.2016, Programit të studimit të Ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznes" i ka vijuar akreditimi. (Ref. Evidenca 65 Urdhër MAS Nr. 434, dt. 25.08.2016 Për Plotësimin e Kushteve për Akreditimin e Programit Bachelor "Administrim Biznes".)

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Dr. Alba Skëndaj dhe PhD. Eriona Shtëmbari. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Znj. Aviola Bardhi, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Universitetin Luarasi që u zhvillua në datën 16 Maj 2023 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për DVV, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në "Administrim Biznesi". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë mbi programin e studimit që akreditohet, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të studentëve të diplomuar. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 12.09.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 33/21 Prot., datë 12.09.2023 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 06.10.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr 130/2 Prot., datë 18.09.2023, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 09.10.2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

Standardi I.2

GVJ bazuar në evidencat e dërguara nga IAL, si dhe në intervistat me studentët dhe stafin akademik konstatoi se shkëmbimet Erasmus ishin në nivele jo të konsiderueshme. Sa I përket praktikave rekomandojmë të ketë marrëveshje bashkëpunimi edhe me institucione të tjera private dhe publike për të shtrirë gamën e partnerëve të biznesit, industrive të përfshira dhe më shumë mundësive për praktikantë mësimore të studentëve.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi II.3

GVJ bazuar në evidencat e dërguara nga IAL, evidentoi që për këtë program studimi literatura e përdorur në shumicën e lëndëve, ishte e pa updateduar dhe e pandryshuar prej kohësh. Kjo literaturë nuk ishte e 5 viteve të fundit.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi II.4

GVJ bazuar në intervistat e kryera me studentët konstatoi se një pjesë e studentëve nuk kishin dijeni për lëndët me zgjedhje të ofruar për programin e studimit.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi II.5

GVJ rekomandon shtimin e bashkëpunimeve me aktorë biznese dhe institucione të tjera private dhe publike si dhe përfshirjen e gjërë të aktorëve për përmirësimin e programit sikurse dhe përditësimin e kurrikulave.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi III.3

Bazuar ne VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 (Shtojca nr. 2), syllabuset hartohen dhe/ose miratohen nga titullari i lendes me grade shkencore.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi III.4

Ky konkluzion u nxor jo vetëm bazuar në kurrikul por edhe gjatë bisedave me stafin akademik. Konkluzioni është në kuadrin e sugjerimit për një rishikim të kurrikulës dhe krahasimin/ differencimin e saj me programin tjetër Bachelor në Financë-Bankë që ofron UL.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi III.5

Rekomandimi i GVJ shkon për zbatimin e së drejtës së studentëve në praktikë. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se studentët nuk kishin dijeni për këtë të drejtë. Jo vetëm gjatë periudhës së pandemisë, por edhe me parë nuk ka (ose ka një nr shumë të kufizuar) të studentëve që përmbyllin studimet bachelor me temë diplome.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.



Standardi VI.1

Rekomandimi i GVJ shkon për analizë përshkrimore më të detajuar dhe specifike të rezultateve të mbledhura nga pyetësorët e studentëve (jo vetëm statistikore), në nivel programesh (Evidenca E.126).

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi VI.2

Sugjerimi i GVJ është pranuar nga IAL.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi VI.3

GVJ vëren se NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimit të syllabuseve për sa kohë ato janë të pa përditësuara me literaturë të 5 viteve të fundit (një pjesë e madhe e lëndëve). GVJ nga evidencat dhe intervistat e kryera, nuk evidentoi zhvillimin e sondazheve për të diplomuarit, apo dhe nga institucione që bashkëpunon. GVJ sugjeron që IAL të përfshijë më shumë mekanizma të diversifikuar të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë në vlerësimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi sikurse dhe më shumë aktorë të ndërlidhur me institucionin.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentit e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Administrim Biznes”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve	
Kriteret	Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Administrim Biznes synon përgatitjen e profesionistëve, që do punojnë në sektorin privat, publik dhe OJF. Programi synon përgatitjen e specialistave të cilët do të mund të pajisen me njohuri dhe dije bashkëkohore për shkencat e manaxhimit dhe administrimit, sikurse dhe me të gjithë shkencat dhe fushat që duhen për të punuar në pozicionin e specialistit të fushës. Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes në UL është në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë e institucionit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe ligjin e arsimit të lartë. Programi synon të respektojë interesat kombëtar në fushën ekonomike, sociale, kulturor dhe më gjërë. Bazuar ne dokumentacion, por edhe nga takimi me drejtuesit e njësisë baze dhe në nivel fakulteti, rezulton se misioni i këtij programi studimi në Universitetin Luarasi është përgatitja e specialistëve të kualifikuar për karrierë në sektorin public dhe privat, dhe ky mision i përshtatet misionit të Universitetit i cili është formimi i specialistëve të lart në fushat e aktivitetit akademik. Misioni i UL nuk bie ndesh me interesat kombëtar, pasi ai synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal. E 3_Statut UL E 4_Rregullore e UL E 5_Plani Strategjik UL E 7_Rregullore FE E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Universiteti Luarasi i ka hartuar programet e studimit në përputhje me ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike, objektive, misionit dhe strategjive të vetë institucionit. Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe drejtuesen e departamentit përforcuam mendimin se programi Bachelor në Administrim Biznes është në përputhje të plotë me vizionin e UL. Programi i studimit Bsc në AB ka si qëllim final të kontribuojë në realizimin e misionit të UL dhe objektivi i tij është formimi i profesionistëve të aftë për tregun e punës të cilët do ti përgjigjen dhe do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit. Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar dhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit duke	



	<p>mundësuar ofrimin e zhvillimit mësimdhënies dhe mësimnxënies për përgatitjen e specialistëve të fushës.</p> <p>E 3 _Statut UL</p> <p>E 4 _Rregullore e UL</p> <p>E 5 _Plani Strategjik UL</p> <p>E 7 _Rregullore FE</p> <p>E 9 _Rregullore Departamenti AB</p> <p>E 10 _Rregullore e Programit BAB</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ evidentoi që Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes është i hartuar në përputhje të plotë me Statutin dhe rregulloren e Universitetit Luarasi. Bazuar në dokumentacion strategjia e UL është në përputhje me strategjitë e zhvillimit të arsimit të lartë në vend dhe ka si qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe përcjelljen më të mirë të dijeve. Kjo strategji është zhvilluar dhe në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznes.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion GVJ ju bë me dije se kurrikulat e lëndëve të këtij programi studimi rishikoheshin dhe përmirësoheshin për të qënë më afër tregut të punës dhe kërkesave që ai ka, duke mundësuar në këtë mënyrë zbatimin e strategjisë së institucionit dhe vetë të programit të studimit.</p> <p>E 3 _Statut UL</p> <p>E 4 _Rregullore e UL</p> <p>E 5 _Plani Strategjik UL</p> <p>E 7 _Rregullore FE</p> <p>E 9 _Rregullore Departamenti AB</p> <p>E 10 _Rregullore e Programit BAB</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i ciklit të parë të studimeve Bachelor në Administrim Biznes është një program i cili ofrohet nga departamenti I Administrim Biznesit në Universitetin Luarasi. Programi I studimit është hapur në vitin 2012 me urdhrin Nr. 483 datë 12.10.2012 të ministrisë së Arsimit si pjesë e programve që ofrohen nga Fakulteti Ekonomik. GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën në institucion në lidhje me përvojën, kapacitetet dhe burimet për ofrimin e këtij programi studimi gjykon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari, Universiteti Luarasi ka një përvojë të hershme në fushën e arsimit. Edhe për këtë program studimi përvoja tashmë është për më shumë se një dekadë. Gjithashtu bazuar në vizitën në institucion na u bë me dije se ky program studimi ka patur përmirësime bazuar në rekomandimet e ardhura nga akreditimi brenda një periudhe shumë të shkurtër. Këtë e evidentuam dhe në dokumentacionet e vëna në dispozicion. - Së dyti, stafi akademik, ku Departamenti i Administrimit ka në përbërje të tij 7 pedagogë të brendshëm, të cilët përbejnë stafin që mban përgjegjësinë për t'u angazhuar në këtë program dhe 9 pedagogë të tjerë janë staf me kohë të pjesshme. Në lidhje me stafin e brendshëm vetëm tre prej tyre mbajnë gradë shkencore.

	<p><i>Rekomandohet rritja e numrit të stafit efektiv për këtë program studimi. Sikurse rekomandohet rritja e stafit akademik të cilët mbajnë gradë shkencore.</i></p> <p>- Së treti, infrastruktura, ku Universiteti Luarasi ofron mjediset e nevojshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, në një godinë bashkëkohore dhe me mjetet e nevojshme visuelle për zhvillimin e mesimit. Godina është rikonstruktuar dhe paisur me mjetet e nevojshme për realizimin e mësimit në këtë program studimi.</p> <p><i>Në përfundim GVJ rekomandon rritjen e kapaciteteve apo burimeve njerëzore, pra stafit akademik të brendshëm për realizimin e këtij programi studimi. Gjithashtu rekomandohet që të rritet numri i stafit akademik të brendshëm të cilët zotërojnë grada shkencore.</i></p> <p>TABELAT BCH Administrim Biznes E 1_Vendimi i Hapjes se SHLUJ Luarasi 2003 E 2_Urdhri Riorganizimi Institucional E 5_Plani Strategjik UL E 7_Rregullore FE E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB E 13_Propozim per Hapje Fakulteti_Programesh E 14_Vendim Hapje Programi FE</p>			
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi Bachelor në Administrim biznes funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit Luarasi, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Programi i studimit që akreditohet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Menxhimit që është njësia bazë e ofrimit të tij. Për këtë program studimi fusha e përgjithshme bazuar në dokumentacion është ekonomike dhe fusha specifike është administrim biznes, fusha të cilat janë në përputhje të plotë me fushat akademike dhe kërkimore të Fakultetit Ekonomik. Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Të gjitha departamentet e Fakultetit Ekonomik bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra tjetrën për arritjen e objektivave të tyre në lidhje me fushat akademike dhe kërkimore.</p> <p>E 7_Rregullore FE E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacion dhe në vizitën në institucion evidentoi që programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Ky program është krijuar dhe ofrohet gjithashtu dhe në përputhje e fushën akademike të njësisë bazë të ofrimit të tij dhe zbaton në mënyrë rigoroze ligjet dhe aktet ligjore në fuqi. GVJ rekomandon rekomandon rritjen e kapaciteteve apo burimeve njerëzore, pra stafit akademik të brendshëm për realizimin e këtij programi studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti Luarasi ka katër fakultete në përbërje të tij. Secila prej këtyre njësive bazë është përgjegjëse për departamentet që ka nën administrim. Universiteti siguron autonominë akademike për secilën strukturë bazë të saj. Programi Bsc në Administrim Biznes, për vetë përmbajtjen e lëndëve që ka menaxhohet plotësisht nga Departamenti i Administrimit. Në Rregulloren e Departamentit të Administrimit paraqiten kompetencat e tij në lidhje me hapjen, riorganizimin, përshtatjen dhe mbylljen e programeve të studimit. Gjithashtu, Departamenti mban përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes së lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në kohë. Të gjitha këto kompetenca, të drejta dhe detyrime të departamentit dhe antarëve përbërës të saj janë të vendosura në rregulloren e departamentit.</p> <p><i>Gjatë vizitës në intitucion GVJ ju bë me dije nga stafi akademik që një ndër kërkesat themelore të tyre ishte rritja e bashkëpunimit kwrkimor shkecor dhe shkrimin e projekteve ndërmjet njësive të universitetit dhe antarëve të tij. Bazuar në këtë GVJ rekomandon institucionin të mundësojë rritjen e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të stafit të tij nw aplikim projektsh dhe veprimtarive kwrkimore shkencore. Përgjegjësitë e personelit akademik janë të vendosura në rregullore dhe titullarët kanë përgjegjësitë e tyre për lëndët që lektorojnë. Analiza e punës së tyre dhe përmirësimi i kësaj pune vjen nga një sërë inputesh. GVJ ju bë me dije se puna e stafit akademik vlerësohej edhe nga studentët dhe cdo fillim viti bëheshin përmirësimet përkatëse, të cilat aprovohehin nga shefja e departamentit.</i></p> <p>Në bashkëpunim me NJSBC, departamenti përpilon në mënyrë periodike raporte për ecurine e punës së tij. Megjithatë në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ gjykon se raporti nuk është përfaqësues për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznes.</p> <p><i>GVJ rekomandon zhvillimin e analizave të cilësisë dhe punës së këtij programi studimi si njësi më vete, pasi rezultatet e tij do të ishin më ndihmuese për përmirësimin e mëtejshëm të programit.</i></p> <p>E 7_Rregullore FE E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB E 115_Analiza NJSBC E 126_Analiza e vleresimit et cilesise_Vlerësimi i cilesise Pyetsori i studenteve</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie</p>	<p>Institucioneve të arsimit të lartë për të realizuar objektivat e procesit mësimor i nevojiten marrëdhëniet e frytshme me institucione homologe dhe me aktorë biznesi.</p>

<p>bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion Universiteti Luarasi ka disa marrëveshje me aktorë vendas dhe të huaj institucione arsimore dhe aktorë biznes. Bazuar po në të njëjtin dokumentacion por dhe në vizitën në institucion, vetë stafi dhe studentët sugjerorin rritjen e këtyre marrëveshjeve.</p> <p><i>Bazuar në këtë GVJ rekomandon që departamenti i Administrimit duhet të synojnë më shumë bashkëpunime me industrinë. Duhet ndërtuar urat e bashkëpunimit me industrinë, biznesin dhe aktorë të tjerë homolog dhe duhet gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikant/interhipet e tyre, por dhe projektet e përbashkëta, mbështetjen e ideve dhe stratupeve të reja, patentim, etj. Gjithashtu rekomandohet dhe rritja e bashkëpunimeve në kuadër të programit ERASMUS, të cilat do të mundësonin lëvizjen e studentëve dhe stafit akademik, pasi sipas dokumentacionit këto bashkëpunime janë të vogla në numër dhe ofrojnë pak mundësi për studentët dhe stafin.</i></p> <p>E23_ Institucionet dhe organizatat bashkepunuese E 25_ Raporti analitik mbi marreveshjet e bashkepunimit 2018-2022 E 28_ Raporti Vjetor 2021_22</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ u njoh me institucionet që Universiteti Luarasi kishte marrëveshje bashkëpunimi. Bazuar në këtë dokumentacion dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij programi studimi praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës etj.</p> <p><i>Megjithatë GVJ rekomandon rritjen e marrëveshjeve me institucione dhe kompani për realizimin e praktikave, si një hap të rëndësishëm për realizimin e qëllimit të praktikave profesionale.</i></p> <p>E23_ Institucionet dhe organizatat bashkepunuese E 25_ Raporti analitik mbi marreveshjet e bashkepunimit 2018-2022 E 28_ Raporti Vjetor 2021_22 E 39_ Udhëzues për Zhvillimin e Praktikës.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në diskutimet e zhvilluara në institucion sikurse dhe me njohjen e dokumentacionit të vënë në dispozicion evidentoi që institucioni harton periodikisht raporte analitike të marrëveshjeve të bashkëpunimit si pjesë e analizës vjetore të fakultetit dhe departamentit. Në këtë analizë vërehet një rritje e marrëveshjeve me institucionet homologe për zhvillimin e konferencave.</p> <p>E 25_ Raporti analitik mbi marreveshjet e bashkepunimit 2018-2022 E 28_ Raporti Vjetor 2021_22</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe në dokumentacion identifikoi që institucioni ka zhvilluar marrëveshje në kuadër të programit Erasmus dhe marrëveshje me institucione të tjera homologe ose jo, por i rekomandohet të zhvillojë më tej marrëveshjet me aktorë të tjerë dhe në kuadër të programit Erasmus. Për një zhvillim efikas të praktikave të studentëve dhe të zhvillimit të shkëmbimeve ndërkombëtare duhet rritur numri i marrëveshjeve që ky institucion ka.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes ka në përbërje të tij lëndë në përputhshmëri me ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015 datë 22.07.2015 dhe gjithashtu Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët në këtë program studimi sipas ligjit të arsimit të lartë ndahen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë - Lëndë karakterizuese - Lëndë ndërdisiplinore dhe Lëndë integruese; - Lëndë plotësuese - Detyrime përmbyllëse <p>Sipas vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 lëndët të ndara sipas kategorive duhet të kenë këtë peshë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A-Lëndë bazë: 15-20% • B-Lëndë karakterizuese: 50-55% • C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: 12-15% • D-Lëndë plotësuese: 10-15% • E-Detyrime përmbyllëse: 3-5 % <p>Në këtë program studimi Bachelor në Administrim Biznes lëndët e kategorizuara sipas ligjit të arsimit të lartë përmbajnë këto kredite:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A-Lëndë bazë: (34 kredite), 18.88 % • B-Lëndë karakterizuese: (99 kredite), 55% • C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (20 kredite), 11.11% • D-Lëndë plotësuese: (21 kredite), 11.66% • E-Detyrime përmbyllëse: (6 kredite), 3.33 % <p>Sipas këtij dokumentacioni dhe përlllogaitjeve GVJ evidentoi një devijancë të vogël nga nivelet ligjore të krediteve të lëndëve në lëndët e kategorisë C, Lëndë ndërdisiplinore/integruese.</p> <p><i>Bazuar në këtë GVJ rekomandon të bëhet një rivlerësim i krediteve të këtyre lëndëve.</i></p> <p>E 61 _Plani Mesimor AB 21-22 E 7 _Rregullore FE E 9 _Rregullore Departamenti AB E 10 _Rregullore e Programit BAB</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion konstaton se objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në Administrim Biznes</p>

<p>veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>është t'u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën e administrimit të biznesit dhe në një sërë fushash të lidhura me administrimin e biznesit me objektiv kryesor formimin e specialistëve të administrimit të biznesit. Bazuar në ligjin në fuqi për arritjen dhe zhvillimin e njohurive dhe kompetencave kërkohet që lëndët bazë dhe karakterizuese të përbëjnë mbi 70% të krediteve të programit të studimit. GVJ evidentoi që lëndët bazë dhe karakterizuese në këtë program studimi përbëjnë më shumë se 70% të programit të tij duke qënë në këtë mënyrë conform ligjit në fuqi. Nga analiza që GVJ i bëri dosjes se programit në të gjithë elemntet e tij, në takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët e këtij programi, GVJ vlerëson se lëndet e ofruara në këtë program, përmbajtja e syllabuseve të tyre, mundësojnë dhe aftësojnë studentin për të punuar në sektorin e menaxhimit, administrimit dhe sipërmarrjes.</p> <p>E 61_Plani Mesimor AB 21-22 E 7_Rregullore FE E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB E 5_Plani Strategjik UL</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion evidentoi që veprimtaritë formuese dhe grup lëndët e këtij programi studimi janë të zhvilluara sipas ligjit në fuqi dhe janë të përcaktuara në planet mësimore me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> <p>Në këtë program studimi Bachelor në Administrim Biznes lëndët e kategorizuara përmbajnë këto kredite:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A-Lëndë bazë: (34 kredite), 18.8888 % • B-Lëndë karakterizuese: (99 kredite), 55% • C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (20 kredite), 11.1111% • D-Lëndë plotësuese: (21 kredite), 11.66666% • E-Detyrime përmblylëse: (6 kredite), 3.33333 % <p>Sipas këtij dokumentacioni dhe përlllogaritjeve GVJ evidentoi një devijancë të vogël nga nivelet ligjore të krediteve të lëndëve në lëndët e kategorisë C, Lëndë ndërdisiplinore/integruese.</p> <p><i>Bazuar në këtë GVJ rekomandon të bëhet një rivlerësim i krediteve të këtyre lëndëve.</i></p> <p>E 61_Plani Mesimor AB 21-22 E 7_Rregullore FE E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB E 5_Plani Strategjik UL</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacion dhe në vizitën në institucion evidentoi përcaktimin e ngarkesës në kredite dhe në orë të praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse. Konkretisht bazuar në ligj praktika profesionale është kategorizuar si Lëndë e kategorisë D Lëndë plotësuese dhe ka gjithësej 3 Kredite dhe 60 orë punë të pavarur të studentëve. Ndërkohë që detyrimet përmblylëse përbëhen nga punimi i Diplomës,</p>




	Lëndë të kategorisë E dhe përkthehen në 6 Kredite. Të gjitha këto ishin të përfshira në planet mësimore. E 61_Plani Mesimor AB 21-22		
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznes kriteret e pranimit përcaktuar janë të bazuara në ligjin për arsimin e lartë Nr. 80 /2015 date 21. 07. 2015. GVJ evidentoi se edhe për financimin e studentëve të ciklit të parë vendimi në Guidën e UL përcakton kategoritë e studentëve që përfitojnë reduktim të tarifave për zhvillimin e arsimit. GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion evidentoi dy llojet e kategorive të financimit. Mënyra e parë ishte nëpërmjet bursave të ekselencës dhe kategoria e dytë ishte nëpërmjet bursave sociale. Bazuar në dokumentacion evidentojmë që forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi janë përcaktuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë E 67_Guida UL E 41_Politikat e Pranimit te Studenteve		
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ evidentoi bazuar në dokumentacion se programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes është i vetmi program studimi bachelor që ofrohet në këtë fushë studimi nga njësia përgjegjëse për të Departamenti i Menaxhimit. E 61_Plani Mesimor AB 21-22		
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ evidentoi bazuar në dokumentacion se institucioni është në pritje të aprovimit nga ministria për kodin e propozuar të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznes. GVJ bazuar në planin mësimor identifikoi kodimin e lëndëve të këtij programi studimi. Ky informacion mbi lëndët, planin mësimor, kodet dhe kreditet e tyre është lehtësisht i aksesueshëm dhe në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. E 18_FE PROPOZIME MBI KODIFIKIMIN E PROGRAMEVE TE STUDIMIT E 61_Plani Mesimor AB 21-22		
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes nuk është një program i përbashkët studimi as me institucione brenda vendit as me ato jashtë vendit.		
Konkluzione	GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion evidentoi që programi i studimit, forma e tij e organizimit, kriteret e financimit të studentëve, kategorizimi I lëndëve dhe kreditet e tyre janë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore për zhvillimin e këtij program studimi është Fakulteti Ekonomik, ndërkohë njësia bazë është Departamenti I Administrim Biznesit I cili është pjese e fakultetit Ekonomik. Bazuar në dokumentacion njësia kryesore Fakulteti Ekonomik përbëhet nga tre departmente të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Departamenti i Administrim Biznesit Departamenti i Ekonomiksit Departamenti Financë Bankë. <p>Njësia bazë e këtij programi studimi, Departamenti i Administrim Biznesit ka në përbërjen e tij shtatë pedagog efektiv të cilë janë me këto tituj:</p> <ul style="list-style-type: none"> Një me titullin Prof.Dr Një me titullin Prof.As.Dr Dy me titullin Doktor Dy pedagogë janë në proces Doktorature Një me titullin Msc <p>Ky department bazuar në dokumentacion në vitin akademik 2022-2023 ka 10 pedagogë me kontratë të cilët mbajnë këto tituj:</p> <ul style="list-style-type: none"> Dy me titullin Prof.As.Dr Katër me titullin Doktor Katër me titullin Msc <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion evidenton që njësia kryesore dhe ajo bazë mbështeten në rregulloret e vendosura nga institucioni për zhvillimin e veprimtarive të tyre, rregullore të cilat janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë.</p> <p>E 3 _Statut UL E 4 _Rregullore e UL E 5 _Plani Strategjik UL E 7 _Rregullore FE E 9 _Rregullore Departamenti AB E 10 _Rregullore e Programit BAB TABELAT BCH Administrim Biznes</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Programi Bachelor në Administrim Biznes ka në përbërje të tij praktikën mësimore. Kjo praktikë zhvillohet në vitin e tretë të studimeve dhe si Lëndë e kategorisë D Lëndë plotësuese dhe ka gjithësej 3 Kredite dhe 60 orë punë të pavarur të studentëve.</p> <p>Referuar dosjes se vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe nga vizita në institucion (me staf dhe studentët), praktikat profesionale mbikëqyren nga pedagog i departamentit, i cili bën mbikëqyrjen e studentit gjatë zhvillimit të praktikës nga ana formale dhe procedurale.</p> <p>E 21 _Programet Mesimore të BAAB_Syllabusët 2</p>




	E 39_Udhëzues për Zhvillimin e Praktikës E 40_Formulari dhe Pasqyra e Praktikës Mesimore_MSHME			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe në komunikimet me stafin drejtues dhe akademik identifikoi që rolin e koordinorit të programit të studimit e mbante drejtuesi i departamentit. Koordinatori i programit është përgjegjës për përmbushjen e misionit të këtij programi dhe përgjigjet për ecurinë e programit.			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion evidentoi që njësia bazë për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznes është bazuar në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Gjithashtu njësia ka vendosur koordinator programi sikurse dhe ndjek me anë të stafit akademik zhvillimin dhe mbarëvajtjen e praktikave mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ bazuar në vizitën e bërë në institucion evidentoi që informacionin në lidhje me programin e studimit, përmbajtjen dhe strukturën e tij, studentët mund ta aksesojnë online në Moodle dhe Share Point. Të dyja platformat janë në përdorim për stafin dhe studentët dhe në to mund të aksesohen informacionet në lidhje me organizimin e programit të studimit, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Këto informacioni GVJ evidentoi që mund të aksesoheshin dhe në faqen zyrtare të institucionit. E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB E 61_Plani Mesimor AB 21-22
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes përmban informacionin në lidhje me lëndët, semestrat ku kryhen, kohëzgjatjen e tyre, orët brenda dhe jashtë auditorit dhe kreditet e lëndëve. Bazuar në dokumentacion GVJ evidentoi që plani mësimor i këtij programi studimi përmban: <ul style="list-style-type: none"> • Emertimi i lëndëve/moduleve të programit të studimit sipas semestrave. • Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi etj) • Numrin e krediteve për cdo lëndë/modul dhe raportin e orëve (leksione dhe seminare) të ndara në semestër dhe raport javor.




	<ul style="list-style-type: none"> Mënyra e kontrollit të dijeve të cdo lënde/moduli (semestri, provim ose provim i ndërmjetëm) numrin e provimeve dhe javëve mësimore. <p>GVJ vlerëson se ky informacion ishte i aksesueshëm nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB E 61_Plani Mesimor AB 21-22 E 21_Programet Mesimore të BAAB_Syllabuset 2</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni bazuar në ligjin e arsimit të lartë ka hartuar dhe shpallur informacionin lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin transferimin dhe ekuivalentimin e studentëve. Në statutin e Universiteti Luarasi, në rregulloret e fakultetit dhe departamentit janë të përcaktuara kriteret për pranimin e studentëve të cilat janë në një linjë me zbatimin e ligjit të arsimit të lartë. Këto kritere përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm kriterin e meritës (nota mesatare e thjeshtë e maturës shtetërore përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore). kriterit e rëndësisë (renditja e aplikantëve fitues bëhet sipas notës mesatare më të lartë, në rend zbritës), bazuar mbi numrin e propozuar të studentëve për tu pranuar. <p>GVJ gjithashtu evidentoi që në statutin e UL ishte e përcaktuar procedura për transferimin dhe ekuivalentimin e studentëve.</p> <p>E 3_Statut UL E 4_Rregullore e UL E 5_Plani Strategjik UL E 7_Rregullore FE E 9_Rregullore Departamenti AB E 10_Rregullore e Programit BAB</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ pasi u njoh me syllabuset e lëndëve të cilat ju vunë në dispozicion, evidentoi që të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara gjenden qartësisht të shprehura në dokumentin 'Plani Mesimor AB 21-22' të Ciklit të Parë Bachelor në Administrim Biznes. Në formacionin e dorëzuar të 'Programet Mesimore të BAAB_Syllabuset 2' GVJ evidentoi që informacioni gjendet për Syllabuset e lëndëve.</p> <p>Formati i Syllabuseve të lëndëve përmbante në mënyrë standarte këtë informacion:</p> <ul style="list-style-type: none"> Titullin e lëndës, Titullarin dhe të dhëna të tjera Gjeneraliste Përmbledhje të lëndës dhe rezultatet e të nxënësve Konceptet themelore të trajtuara Temat e lëndës Formatet e kontrollit të dijës dhe frekuentimi Literaturën e detyruar dhe të rekomanduar Shpjegime të tjera nga titullari




	<p>Megjithatë, GVJ evidenton që:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në të gjitha lëndët (syllabuset) mungon paraqitja e Tipologjisë së lëndës sipas germëzimit dhe PM miratuar; Ka mosperputhje në nr.krediteve të paraqitura në syllabus me nr. e krediteve respektive të lëndës në planin mësimor të miratuar të miratuar 2022-2023; Në disa lëndë mungon shpjegimi i cdo teme shoqëruar me literaturën përkatëse të detajuar me faqe; Në disa lëndë literature e detyrueshme paraqitet me vit botimi jo brenda 5 viteve të fundit <p>E 61 _Plani Mesimor AB 21-22 E 21 _Programet Mesimore të BAAB_Syllabuset 2</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Rregulloret e institucionit përcaktojnë që lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Bazuar në vizitën në institucion GVJ ju bë me dije se këto rishikime bëhen në lidhje me dinamikat e tregut të punës. Sipas kësaj rregulloreje ndryshimet propozohen nga Departamenti, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me ekspertë të fushës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. GVJ evidentoi që për këtë program studimi literature e përdorur ishte e pa udatuar dhe e pandryshuar prej kohësh. Kjo literaturë nuk ishte e viteve të fundit. Ndryshimet e syllabuseve duhet të lidhen me përditësim dhe rifreskim të tyre bazuar në zhvillimet e fundit të shkencës, zhvillimet e ndryshme ekonomike dhe sociale sikurse dhe me ndihmën e ekspertëve të fushës.</p> <p><i>Për këtë GVJ rekomandon udatimin e literaturës së lëndëve që ofrohen në këtë program studimi.</i></p> <p>E 61 _Procedura për rishikimin e kurrikulës E 61 _Plani Mesimor AB 21-22 E 21 _Programet Mesimore të BAAB_Syllabuset 2</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi mësimor i programit Bachelor në Administrim Biznes është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. GVJ evidentoi bazuar në vizitën në institucion se ky program i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet formave fizike dhe elektronike. Rekomandohet përditësimi i syllabuseve të lëndëve në këtë program.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes është ndërtuar për të mundësuar marrjen e njohurive nga studentët në fushën e menaxhimit. Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të menaxhimit dhe administrimit të biznesit.</p> <p>GVJ konstaton se, ky programi i jep një peshë të madhe lëndëve të profilit financiar, në masën 40 ECT, përkundrejt 48 ECTS lëndë të profilit menaxhim. Gjithashtu GVJ bazuar në vizitën në institucion evidentoi që studentët nuk kishin njohuri në lidhje me lëndët me zgjedhje që janë lëndë të kategorisë C. Praktikisht, kategoria C e lëndëve me zgjedhje nuk i ofrohet studentëve, duke mbetur vetëm me profilin e lëndëve të detyrueshme e duke cënuar kështu mundësinë e studentit për thellim në një specialitet që dëshiron brenda fushës së gjerë të menaxhimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e lëndëve me profil administrim biznesi dhe lëndëve me zgjedhje për ti ofruar mundësi studentëve të thellohen në specialitete brenda fushës së administrimit.</i></p> <p>E 61 _Plani Mesimor AB 21-22 E 21 _Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ evidentoi që programi Bachelor në Administrim Biznes zhvillohet brenda tre viteve akademike, të shpërndarë në semestral. Ky program ka 180 kredite ETCS të cilat janë të shpërndara në lëndë e module në këtë mënyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A-Lëndë bazë: (34 kredite), 18.8888 % • B-Lëndë karakterizuese: (99 kredite), 55% • C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (20 kredite), 11.1111% • D-Lëndë plotësuese: (21 kredite), 11.66666% • E-Detyrime përmblyese: (6 kredite), 3.33333 % <p>Sipas këtij dokumentacioni dhe përlllogajtjeve GVJ evidentoi një devijancë të vogël nga nivelet ligjore të krediteve të lëndëve në lëndët e kategorisë C, Lëndë ndërdisiplinore/integruese.</p> <p><i>Bazuar në këtë GVJ rekomandon të bëhet një rivlerësim i krediteve të këtyre lëndëve.</i></p> <p><i>Gjithashtu rekomandohet rishikimi i lëndëve në këtë program për të shtuar lëndët me profil administrimi dhe lëndët me zgjedhje.</i></p> <p>E 61 _Plani Mesimor AB 21-22 E 21 _Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Por për një përafrim më të madh me profilin e programit, <i>GVJ pasi u njoh me lëndët përbërëse të këtij programi studimi rekomandon shtimin e lëndëve me profil administrimi në këtë program për një arritje më të mirë të objektivave të vendosura.</i></p> <p>E 61 _Plani Mesimor AB 21-22 E 21 _Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>




<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në ligjin e arsimit të lartë në Shqipëri, kategoritë në të cilat janë ndarë lëndët e këtij programi studimi janë pesë. Lëndët të vendosura në këto kategori janë të ndara në kredite dhe janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A-Lëndë bazë: (34 kredite), 18.8888 % Ku ligji detyron 15%-20% • B-Lëndë karakterizuese: (99 kredite), 55%, Ku ligji detyron 50%-55% • C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (20 kredite), 11.1111% , Ku ligji detyron 12%-15% • D-Lëndë plotësuese: (21 kredite), 11.66666%, Ku ligji detyron 10%-15% • E-Detyrime përmbyllesë: (6 kredite), 3.33333 % , Ku ligji detyron 3%-5% <p>Kategorizimi është konfort Shtojcës nr 1 në vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019. Ky program studimi ka të përfshirë formimin praktik nëpërmjet praktikës mësimore dhe formave të tjera përgjatë zhvillimit të lëndëve.</p> <p><i>Bazuar në kreditet e vendosura sipas kategorizimit ligjor në këtë program studimi, GVJ rekomandon të bëhet një rivlerësim i krediteve të këtyre lëndëve për të shtuar lëndë apo kredite në lëndët ndërdisiplinore/integruese.</i></p> <p>E 61 _Plani Mesimor AB 21-22 E 21 _Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, përkatësisht syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se në përgjithësi në syllabusin e cdo lënde paraqitet informacion i detajuar.</p> <p>GVJ evidentoi që literature bazë e përdorur në këtë program studimi, nuk është një literaturë e viteve të fundit. Edhe pse janë bërë përpjekje për të integruar në program literature shtë në lëndë të ndryshme përbërëse të programit, nuk ka patur ndryshime në literaturat bazë.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ evidentoi që pothuajse asnjë lëndë e programit nuk ka si literaturë bazë, një literaturë të pesë viteve të fundit.</p> <p><i>Për këtë arsye GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të lëndëve në këtë program mësimor e cila do të ishte një vlerë e shtuar pasi do të kishte përditësimet e fundit të shkencës të lidhura me rezultatet e kërkesave të tregut të punës.</i></p> <p>E 61 _Plani Mesimor AB 21-22 E 21 _Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e këtij program thëllon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Për të zhvilluar njohuri në fushën e menaxhimit programi përmban këto lëndë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Hyrje në Administrim Biznesi b. Menaxhimi i SME c. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore d. Sjellje Organizative

	<p>e. Menaxhimi i Operacioneve f. Strategji Biznesi, etj.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion ky program studimi përmban në një masë të madhe lëndë të profilit financiar. <i>Për të garantuar një thellim gradual në dijet e ofruara në fushën e administrimit dhe për të mundësuar përfitimin e synuar të dijeve menaxheriale GVJ rekomandon përfshirje më të madhe të lëndëve me profil menaxherial.</i> E 61_Plani Mesimor AB 21-22 E 21_Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>						
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznes, njohuritë e marra në këtë program mundësojnë thellimin e tyre të mëtejshëm për studentët në cikle më të larta studimi. Vetë përmbajtja e programit të studimit është ndërtuar për të ofruar mundësi të mëtejshme specializimi dhe studimi. GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion evidentoi se programi i studimit Bachelor në Administrim Biznes mundëson zhvillimin e mëtejshëm akademik të studentëve sikurse dhe punësimin e tyre si specialist pas përfundimit të studimeve në këtë cikël studimi. E 61_Plani Mesimor AB 21-22 E 21_Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën në institucion evidentoi që përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje të plotë me objektivat e tij formuese, por rekomandon që të mundësojë ofrimin e më shumë lëndëve të profilit të administrimit të biznesit. Gjithashtu GVJ rekomandon përfshirjen e lëndëve me zgjedhje dhe bërja me dije e studentëve për mundësitë për këto lëndë. Gjithashtu rekomandojmë të shikohen lëndët e kategorisë C në mënyrë që të jenë në përputhje me ligjet në fuqi për numrin e krediteve të tyre.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>Bazuar në vizitën e zhvilluar në institucion në takimin me stafin akademik na u bë me dije se cdo fillim të vitit akademik stafi mbledhet dhe diskuton për kurikulën dhe për përmirësimet e mundshme. Këto përmirësime dhe ndryshime miratohen nga shefi i departamentit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion përmirësimet e bëra kohët e fundit lidhen me shtimin e rasteve studimore të cilat zhvillohen në seminare. Këto ndryshime kanë ardhur nga analizat e pyetësorëve që i bëhen studentëve për përmirësimin e programit sikurse dhe nga lidhjet me aktorë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 23

<p>institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>të tjerë. Zhvillimi i pyetësorve të studentëve lidhet me cilësinë e programi dhe mësimdhënies dhe analiza e tyre ndihmon përmirësimin. Edhe pse në dokumentacionin e vënë në dispozicion theksohen ndryshimet dhe përmirësimet e kurrikulës ajo që vihet re edhe në takimin me stafin është eksistenca e literaturës jo të re.</p> <p><i>Për këtë arsye GVJ rekomandon përditësimin e literaturës në këtë program studimi si një hap shumë i rëndësishëm i përmirësimit dhe i lidhjes së programit me të rejtat më të fundit të shkencës.</i></p> <p>E 61_Procedura per rishikimin e kurrikules E 61_Plani Mesimor AB 21-22 E 21_Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion GVJ evidentoi organizimin dhe përfshirjen e studentëve dhe stukturave të tyre në diskutime për përmirësimin e programit të studimit. Një nga mënyrat e përfshirjes së studentëve në përmirësim është analiza dhe rezultatet e mendimeve dhe vlerësimeve të tyre për programin e studimit. Një tjetër mundësi e nxitjes së studentëve bazuar në dokumentacion është përfshirja e tyre në struktura si Këshillat studentor, Senat, Borde administrimi të cilat mundësojnë dëgjimin e studentëve në institucion.</p> <p>GVJ bazuar në takimin që zhvilloi me studentët në institucion gjykon që studentët janë të përfshirë në përmirësimin e mundshëm të programit dhe të mësimdhënies.</p> <p>E 54_Lista e anetareve të Senatit Akademik UL E 55_Rregullore e Këshillit Studentor E 116_Statuti i Këshillit Studentor E 56_Rregullore e Zyrës së Studentit dhe të Këshillimit të Karrierës</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe takimeve me titullarët e fakultetit, konstatoi së është në fokus të institucionit bashkëpunimi me organizatat/kompanitë publike dhe private, institucione kërkimore e shkencore, duke i pare si pjesë integrale e aktivitetit të Fakultetit të Ekonomisë. Edhe pse ky fokus është përcaktuar në strategjitë e institucionit, niveli I marrëveshjeve me institucione dhe kompani është I ulët. Njëkohësisht ndryshimet në literature nuk janë zhvilluar prej vitesh.</p> <p><i>Për këtë arsye GVJ rekomandon rritjen e marrëveshjeve dhe marrëdhënieve me institucione dhe kompani sikurse dhe përditësimin e literaturës duke përfshirë dhe aktorë të tjerë në sugjerime.</i></p> <p>E 5_Plani Strategjik UL E 8_Plani Strategjik i Zhvillimit të FE E 12_Strategjia e zhvillimit të DAB E 61_Plani Mesimor AB 21-22 E 21_Programet Mesimore te BAAB_Syllabuset 2</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në vizitën në institucion evidentoi përfshirjen e studentëve në përmirësimin e programit të studimit. GVJ bazuar në dokumentacion GVJ rekomandon shtimin e bashkëpunimeve me aktorë biznese dhe institucione të tjera private dhe publike. Një tjetër rekomandim është përfshirja e gjërë e aktorëve për përmirësimin e programit sikurse dhe përditësimin e kurrikulave.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive përfshijnë: leksione dhe seminare, leksione të hapura, detyra/projekte kursi, raste studimore, të pasqyruara në syllabuset lëndore; praktikë profesionale, detyrime përmbyllëse.</p> <p>Evidenca 21, 47</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik zhvillon mësimdhënien në forma, mënyra, metoda të ndryshme për t'ju përgjigjur larmisë dhe nevojave të studentëve, praktikë kjo e evidentuar edhe nga takimet në institucion. Universiteti ka vënë në dispozicion edhe LMS "Moodle Luarasi".</p> <p>Praktika që ndiqet për të analizuar çfarë sugjerimesh dhe kërkesash janë marrë nga studentët, si janë zbatuar dhe ndjekur ato, dhe çfarë praktikash të tjera janë përshtatur me nevojat e studentëve për secilën lëndë të programit <i>mund të specifikohet më mirë në rregullore</i>.</p> <p>Fakti që studentët kanë mundësi të ndjekin praktika mësimore pranë kompanive është pozitiv megjithëse, duke qenë të punësuar gjatë kohës së studimeve, studentët i ndjekin praktikat kryesisht pranë kompanive të tyre</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Universiteti "Luarasi" ka miratuar Udhëzuesin e Metodave Inovative të mësimdhënies", I cili shpjegon cilat janë elementet kryesore të planifikuara në mbështetje të zhvillimit të statit akademik të universitetit. <i>GVJ sugjeron që këto aktivitete të pasqyrohen në raporte të cilat të analizojnë sa anëtarë stafi marrin pjesë në këto trajnime në përgjithësi dhe sa nga programi i studimit BAB në shqyrtim, dhe sa efektive kanë qenë këto trajnime në rezultatet e pritura.</i></p> <p>Evidenca 90 dhe 100</p> <p>E 82 Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kriteret ligjore të kualifikimit. Ai angazhohet në nxitjet e studentëve dhe mësimxënie nëpërmjet detyrave të kursit dhe aktiviteteve për çdo lëndë.</p> <p>UL, sipas evidences 90, por edhe NJSBC organizon trajnime me stafin akademik, në kuadër të mësimdhënies, çdo vit akademik.</p> <p>RVB referon se stafi akademik është përgjegjës edhe për mentorimin e studentëve me qëllim arritjen e objektivave profesionale dhe akademike.</p> <p>Pedagogët e çdo lënde duhet të sigurohen që pavarësia dhe mësimi i studentëve nuk kufizohet vetëm në anën praktike, po dhe në anën konceptuale.</p>

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p><i>Për këtë duhet më tepër evidencë në lidhje me metodat e nxitjes së debatit, diskutimit dhe mendimit ndryshe në klasa, sa të hapur janë pedagogët e lëndëve për të pranuar mendime ose përgjigje alternative nga studentët.</i></p> <p>Evidenca 105</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. GVJ mësoi gjatë takimeve në institucion se NJSBC ndërmerr vlerësime nëpërmjet pyetësprit të studentëve dhe stafit akademik, me qëllim që të identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Gjithashtu, pyetëm dhe morëm përgjigje gjatë takimeve në IAL, se nuk ka patur raste vërejtjesh për përmirësim apo ndryshime për format e metodat e mësimdhënies. Gjatë takimit me trupën akademike, u referua se bëhet përditësim i syllabuseve dhe materialeve. Këto ndryshime bëhen nga pedagogët duke marrë parasysh edhe vlerësimet e studentëve në një proces të mbikëqyrur nga departamenti. <i>GVJ sugjeron që këto ndryshime të pasqyrohen edhe në syllabuset e lëndëve, pasi evidenca 21 përmaban literaturë përtej 5 vjecarit të fundit.</i> Kurse Evidenca 115 jep analize të të gjithë programeve të studimit. <i>Sugjerohet të bëhet një analizë e vecantë për programin e studimit.</i></p> <p>Evidencat 21, 118, 120, 127, 115</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Universiteti “Luarasi” ka miratuar Udhëzuesin e Metodave Inovative të mësimdhënies” dhe NJSBC organizon trajnime me stafin akademik, në kuadër të metodave të mësimdhënies me qëllim përmirësimin e aftësive të stafit akademik.</p> <p><i>GVJ rekomandon të paraqitet dhe një informacion më i saktë sa pedagogë marrin pjesë në secilin trajnim, dhe të analizohet nëse rezultatet e atyre që marrin pjesë rezultojnë më të larta në mësimdhënie në krahasim me ata që nuk marrin pjesë në trajnime.</i></p> <p>Evidenca 12, 122</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UL garanton procesin e të nxëniet dhe aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që aktivitetet trajnuese të pasqyrohen në raporte të cilat të analizojnë sa anëtarë stafi marrin pjesë në këto trajnime në përgjithësi dhe nga BAB, dhe sa efektive kanë qenë këto trajnime në rezultatet e pritura.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>




Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstatoi nga takimet në UL dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të studimit. Kontrolli i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegjumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; rastet studimore për problematikën e disiplinës; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve. Evidenca 21. Programet mësimore syllabuset BAB (Syllabuset) Evidenca 10. Rregullore e Programit BAB
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Pedagogu i lëndës, para fillimit të çdo semestri, bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. Specifikimet e çdo lënde përkatëse jepen nëpërmjet syllabuseve sipas evidencës 21 specifikisht për programin e studimit. <i>Por syllabuset nuk kane titullar lende, sic kerkon kriteri i vleresimit.</i> Syllabuset informojne studentet për përmbajtjen e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit kur regjistrohen dhe në fillim të çdo lënde. Evidenca 21. Programet mësimore Syllabuset BAB
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Rregullorja e programit paraqit qartë lëndët dhe njohuritë që marrin studentët nga ky program. Testimi dhe vlerësimi i njohurive ne programin e studimit bëhet në mënyrë shume diverse dhe kumulative. Gjithsesi, provimi përfundimtar mbetet mënyra kryesore dhe standarde e vlerësimit për gati të gjitha lëndët. Evidenca 21. Programet mësimore syllabuset BAB Evidenca 134 Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti AB dhe stafi akademik i programit mblidhen në fund të vitit akademik për të vlerësuar dhe përmirësuar format e metodat e mësimdhënies. Në mbledhjet e departamenti ftohen edhe përfaqësues të studentëve të programit të studimit. Po ashtu, NSBC bërë vlerësime nëpërmjet pyetësorit online. Evidenca 115
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të	Bazuar në Rregulloren e Departamentit AB dhe në Rregulloren e Programit BAB, janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 28

shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar studenti gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/ modulit si aktivizim në mësim, testimi i ndërmjetëm/ detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve. GVJ konstaton se format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Shefi i departmentit dhe stafi akademik i programit investojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.			
	Evidenca 21. Programet mësimore syllabuset BAB Evidenca 10. Rregullore e Programit BAB			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton nga programee e lëndëve (evidenca 21) se vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë diverse dhe kumulative, por përqindja e secilit komponent ndryshon në varësi të lëndës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga verifikimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e Departamentit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit dhe vlerësimi përfundimtar. Nota përfundimtare del si rezultat kumulativ i pikëve të vlerësimit të vazhduar dhe provimit përfundimtar.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Universiteti përdor sisteme elektronike për mësimdhënie dhe menaxhimin e provimeve, si Platforma "Moodle Luarasi LMS" dhe Platforma Office 365. Evidenca 4. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Moodle tutorial
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin (evidenca 21). Sic u përmend më lart, GVJ konstatoi gjatë vizitave në institucion si edhe nga kontrolli I evidences 21 që syllabuset nuk kanë një titullar lënde, sipas bazës ligjore në fuqi. <i>Përfshirja e dy pedagogëve ku njëri është titullari i lëndës, garanton cilësinë dhe mund të shtrihet edhe në hartimin e tezave dhe monitorimin e procesit të provimit.</i> Evidenca 21. Programet mësimore të lëndëve syllabuset BAB
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Gjate takimeve me studentët, GVJ u informua që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 29

<p>shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, etj. në orët e fundit të seminareve). Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti i AB, si njësi bazë që ofron programin e studimit AB dhe stafi akademik I angazhuar në program marrin masa ndaj studentëve për të shmangur plagjiaturën në detyrat e tyre të kursit. Gjithashtu, komisioni përgjegjës për provimet e secilës lëndë, ndalon në mënyrë të rrepte kopjimin në provimet e ndërmjetme apo në ato perfundimtare.</p> <p>Evidenca 7 Rregullore FE Evidenca 10. Rregullore e Programit BAB Evidenca 36. Rregullore e provimeve Evidenca 117 Kodi i Etikës</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë proçesit të kontrollit stafi shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdesshëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit. Rezultatet e provimit jepen brenda 5 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit.</p> <p>Evidenca 7 Rregullore FE Evidenca 10. Rregullore e Programit Evidenca 36. Rregullore e provimeve</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UL, studentët kanë të drejtë të rishikojnë provimet. Gjithashtu, UL ka bërë aktiv sistemin PITAGORA, për të rritur transparencën e vlerësimeve të studentëve.</p> <p>UL ka procedurë të pasqyruara në rregulloret e FE, provimeve dhe ankimit të studentëve. Sipas RVB dhe takimit me studentet, ata i drejtohen Departamentit për fillimin e procedurave për ngritjen e një komisioni Ad-hoc për ri-vlerësimin e provimeve të studentëve që kanë ngritur këtë pakënaqësi.</p> <p>Evidenca 7 Rregullore FE Evidenca 36. Rregullore e provimeve Evidenca 3 Statuti i UL Evidenca 76 Manual Studente Online Evidenca 77 Pitagora Manual Nota Studenti Evidenca 78 Pitagora Manual Publikimi i Programeve Evidenca 79 Pitagora Manual Evidenca 103 Proçesi i Vlerësimit Pitagora Evidenca 104 Proçesi i Mungesave Pitagora Evidencë 132 Rregullore e Ankimit të Studentëve</p>




<p>kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut.</p> <p>Nuk ka evidenca për pjesëmarrjen e studentëve në konferenca dhe punime shkencore.</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni organizon leksione të hapura duke ftuar folës të jashtëm akademike ose nga biznesi. Këto leksione ofrojnë mundësi për studentët të zgjerojnë njohuritë e tyre përtej programit.</p> <p>Evidenca 57 Trajnime/ aktivitetet</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se, ky programi i jep një peshë të madhe lëndëve të profilit financiar, në masën 40 ECT, bazuar në kurrikulën e programit (tabela 9), përkundrejt 48 ECTS lëndë të profilit menaxhim. Po ashtu, kategoria C e lëndëve me zgjedhje nuk i ofrohet studentëve.</i></p> <p><i>Për këto arsye, sugjerohet të bëhet rishikim kurrikule ku të rritet nr. i lëndëve të menaxhimit dhe të shikohen mundësi të futjes së lëndëve të tjera më të vlefshme për menaxherë dhe administrim biznesi si psh. Biznes Elektronik apo Tregeti Elektronike, etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;">X</p>				

<p>Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të</p>	<p>Evidenca 37 paraqet procedurën e posaçme për detyrimet përmbyllëse. Rregullat e punimit dhe dorëzimit të diplomës përcaktohen gjithashtu edhe në rregulloren e përgjithshme të institucionit.</p> <p>Gjatë vizitave në institucion, GVJ konstatoi se shumica e studentëve nuk kishin informacion për detyrimet përmbyllëse me një temë diplome, për studentët me mesatare 8 e lart (E37, neni 3), si mundësi alaternativë e provimit të përgjithshëm. Po ashtu, nuk kishin ende informacion për datën</p>




<p>drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>e provimit të përgjithshëm, edhe pse në rregulloren e diplomimit, neni 5, pika 2 thot se “sipas planit të vitit akademik, të miratuar në fillim të vitit, caktohet data/datat e kryerjes së provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomave”.</p> <p><i>GVJ rekomandon të merren masa për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe ofrimin e mundësisë së mbrojtjes së diplomave krahas provimit të përgjithshëm.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>E37. UL Rregullore e diplomimit.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nuk ka evidenca për përmbushjen e këtij kriteri. GVJ pyeti studentët lidhur me provimin final dhe ata nuk kishin ende një set pyetjesh mbi të cilat të bazonin studimin.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Rregullorja e UL dhe ajo e diplomimit parashikojnë orientimin dhe asistimin e studnetëve nga një udhëheqës për punimin e temës së diplomës.</p> <p>Ka një evidence (E6) të kërkuar shtesë nga GVJ, për temat e mbrojtura në vitin 2019, por studentët e gjeneratës nga viti 2020 e në vijim nuk kanë një informacion të tillë, sic komentojmë më lart.</p> <p>E 6 Doc shtese_Bch AB proev vlersim diplome studente 2019.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në RVB, E7 dhe 37, Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga</p>	<p>Studenti me mbarimin e studimeve pajiset me Diplomën dhe Suplementin e diplomës, Listën e notave. Me kërkesën e tyre u vihet në dispozicion edhe njv kopje e programit të studimit.</p>

<p>ministra përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Këto dokumenta janë sipas formatit të miratuar nga MASR dhe të paraqitur si evidencë nga institucioni për këtë proces vlerësimi në Evidencën 30.</p> <p>Institucioni ju jep të drejtën studentëve të kërkojnë dhe të marrin një kopje të plotë të programit mësimor dhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara të firmosur nga titullari i institucionit.</p> <p>RVB Evidenca 22 Evidenca 30</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Të dhënat e studentëve dhe rezultatet e tyre ruhen nga sekretaria mësimore.</p> <p>Nga takimi konfirmohet se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni mban të dhënat e kontaktit dhe i azhuron ato për studentët pas diplomimit.</p> <p>RVB Evidenca 68</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ rekomandon të merren masa për zbatimin e rregullores së diplomimit dhe ofrimin e mundësisë së përmbylljes së studimeve edhe nëpërmjet punimit të diplomave krahas provimit të përgjithshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kriteret ligjore të kualifikimit. Departamenti i BA përbëhet nga 7 anëtarë PAE, nga të cilët 1 me titullin Prof.Dr, 1 Assoc.Dr, 2 Dr. Gjithashtu departamenti ka edhe 10 pedagogë të jashtëm.</p> <p>Referuar tabelave 12,1-12,4 në RVB, raporti PAE/PAK paraqitet si vijon: Viti 2020-2021 PAK/PAK = 65%/35% Viti 2020-2021 PAK/PAK = 61,5%/38,5% Viti 2021-2022 PAE/PAK =63%/37% Viti 2022-2023 PAE/PAK = 60%/40%</p> <p>Sic vërehet, ngarkesa mësimore në program NUK plotëson detyrimin ku të paktën 70% e orëve të programit duhet të mbulohet nga personel akademik PAE.</p> <p><i>Sugjerohet që departamenti të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi.</i></p> <p>RVB tabela 6, 12.3 Evidenca 105</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Informacioni I paraqitur në Tabelat 4 dhe 9 në RVB është I paplotë dhe pasqyron vetëm ngarkesën në orë mësimore (lëndore), duke mos përfshirë orët për udhëheqjen e temave të diplomës në UL.</p> <p><i>Referuar llogaritjeve të mësipërme kriteri 1), sipas informacionit të tabelave 12 mbi ngarkesën mësimore, personeli PAE mbulon më pak se 70% të ngarkesës mësimore të programit. Për këtë arsye sugjerohet sa më sipër.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Ky kriter plotësohet pasi, referuar RVB dhe vizitave në institucion, pjesa më e madhe e stafit akademik PAE kanë mbi 5 vite të angazhuar në FE.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,</p>	<p>Procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të hartuara në përputhje me bazën ligjore dhe të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e brendshme të UL.</p> <p>Përsa i përket përmbushjes së pjesës së fudit të këtij kriteri: përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Referuar njoftimeve në faqen web të institucionit, konstatohet se UL bën publike thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p>

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<i>Sugjerohet që në këtë thirrje të publikohet edhe procedura si dhe metodologjia e vlerësimit nga komisioni ad hoc.</i> Evidenca 95, 98
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	UL ka hartuar rregullore të vecanta të cilat përcaktojnë qartë rolin dhe kopetencat e personelit ndihmës akademik. Evidencat 4, 15, 27, 53, 68
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UL mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit BAB, personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe të personelit ndihmës akademik të angazhuar në këtë program studimi. Nëpërmjet konsultimit të dosjeve të stafit të përzgjedhur në mënyrë rastësore u konstatua se dokumentacioni i mbledhur dhe ruajtur nga zyra e Burimeve Njerëzore konsiston në: CV, Kontratë, Librezë pune, Fotokopje ID, Diploma dhe listë notash të noterizuara, Certifikatë të gjuhës së huaj, etj. <i>CV, Raport Mjeko-Ligjor dhe Librezë shëndetësore janë kryesisht të pa përditësuara.</i> <i>GVJ konstatoi se kontratat kanë këto parregullsi:</i> <ul style="list-style-type: none">- ka kontrata pune me afat të pacaktuar për stafin akademik Msc,- nuk përcaktojnë ngarkesën mësimore,- për stafin PAK nuk ka leje angazhimi nga qendra e tyre e punës
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Gjatë vizitave në institucion, GVJ iu referua se praktika mësimore koordinohet nga një staf akademik, së bashku me Zyrën e Karrierës Praktika profesionale, dhe në bashkëpunim me institucionet ku UL ka marrëveshje bashkëpunimi. Përsa i përket punimit të diplomës, gjatë takimeve në institucion u referua se në DAB ato mbulohen kryesisht me PAE (3-5 diploma secili) por ka edhe PAK. <i>Punimet e diplomave për programin e studimit AB, janë aplikuar deri në v. 2019, më pas nuk ka evidence dhe studentët nuk kishin informacion lidhur me këtë mundësi.</i>
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin	UL përmbush këtë kriter duke vënë në dispozicion një kordinator për ndjekjen e praktikave deri në mbrojtjen e tyre para një komisioni. RVB, Evidenca 39



përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky kriter përmbushet kryesisht, pasi ka parregullsi në kontratat e personelit akademik, si edhe personeli PAE mbulon më pak se 70% të ngarkesës mësimore të programit, duke mos plotësuar detyrimin ligjor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar evidencave si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se UL disponon laborator informatike, auditorë për leksione dhe seminare, bibliotekë, ambiente për personelin akademik dhe administrativ, mjedise këto të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, si dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit BAB. Tabela 16, RVB
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga informacioni i vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni disponon salla për seminare dhe leksione të pajisura me projektorë dhe tabela. Gjatë pandemisë mësimi u zhvillua online dhe institucioni vazhdon të verë në dispozicion platformat online. UL ka 5 laboratore me 120 pc me parametra bashkëkohore. Ekspertët konkludojnë se këto mjedise janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit të programit BAB, por do të ishte me mire që laborator i teknologjisë të jetë i pajisur plotësisht me programe softwarike, përveç SPSS për analizat sasimore edhe programe të tilla si Nvivo etj. për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit shkencor cilësor, për ti përgatitur studentët për ciklin e dytë të studimeve.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Evidenca 87
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të	UL bashkëpunon me institucione publike dhe private të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe veprimtarive të tjera praktike.

pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Evidenca 39, 87			
Konkluzione	<i>Ky kriter permbushet plotesisht, pasi UL ka vëne në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura baze e referuar ne syllabuse dhe ajo fizike që disponohet në bibliotekë, tejkalon 5 vjecarin e fundit. Gjatë takimeve në institucion, GVJ mësoi se stafi akademik ve në dispozicion të studentëve kopje elektronike të përditësuara, qe presupozohet ti vihet studenteve ne dispozicion ne Moodle. Evidenca 50
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë takimeve në institucion u referua se stafi akademik rishikon syllabuset dhe literaturën e referuar në to, por për këtë nuk ka evidenca. <i>GVJ sugjeron që njësia përgjegjëse të planifikojë një plan-buxhet me zë të vecantë për përditësimin e literaturës dhe të raportojë këto përditësimet edhe në raportet që harton.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit BAB bibliotekën mësimore dhe ju garanton atyre mundësi të barabartë shfrytëzimi. Biblioteka u vizitua gjatë vizitës në institucion.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të depozituar nga IAL si edhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se biblioteka është e pajisur në literaturë si tekste mësimore bazë dhe literaturë ndihmëse në fushën ekonomike (Ref. RVB). <i>Por GVJ konstaton se kjo literaturë është përtej 5-vjecarit të fundit në disa fusha.</i> <i>GVJ rekomandon që institucioni të pasurojë literaturën e bibliotekës me një gamë më të gjerë botimesh bashkëkohore librash në gjuhën shqipe dhe angleze, si libra, revista shkencore e periodikë për programin e studimit.</i>

Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Referuar RVB studentet kanë mundësi të shfrytëzojnë pa pagesë bibliotekën online.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Referuar RVB, biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.			
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka në UL qëndron e hapur gjatë periudhës e hene - e Premte në orarin 8-20.00 dhe gjatë sezonit të provimeve me orar të zgjatur. Kapaciteti i sallës së bibliotekës është 20 persona, e cila duket të jetë e relativisht e vogël në përgjigje të numrit të studentëve në UL. Evidenca 53, 86			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Sic evidentohet edhe më sipër, Evidenca 50 Lista e literatures në funksion të programit pasqyron literaturë për të 5-vjecarit të fundit. Titulli më i ri është botim i vitit 2014. Megjithatë institucioni mundohet ta plotësojë me titull elektronik më të përditësuar.			
Konkluzione	<i>GVJ rekomandon që institucioni të hartojë plan buxhet zë të vecantë dhe të pasurojë literaturën e bibliotekës me një gamë më të gjerë botimesh të përditësuar librash në gjuhën shqipe dhe angleze, si libra, revista shkencore e periodikë për programin e studimit. Gjithashtu, të shikohet mundësia e zgjerimit të kapacitetit të bibliotekës në funksionin e saj edhe si sallë studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion dhe vizitës në institucion, se informacioni lidhur me studentët e programit të studimit mbahet nga sekretaria mësimore me anë të regjistrave manualë. Gjithashtu, është vënë në dispozicion edhe sistemin online Pitagora, ku çdo student ka kredencialet e tij për të marrë informacion të personalizuar lidhur me notat apo lëndët që duhet të frekuentojë.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Ndërkohë të dhënat dhe dokumentacioni i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, mbahet në dosje nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatuan se UL mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit personelit akademik dhe studentëve nëpërmjet emailëve zyrtarë, platformës elektronike MOODLE-LMS, Microsoft Office (sharepoint).</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Evidenca 47, 76, 84, 103, 104</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstaton se informacionet lidhur me programin e studimit MSHAB, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në gjuhën shqipe, dhe pjesa më e madhe e tyre edhe në gjuhën angleze, kjo e fundit në process zhvillimi nga IT.</p>




Konkluzione	<i>GVJ konkludon se ky kriter përmbushet plotësisht, pasi UL disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar rregullores së UL dhe evidencës 42, si edhe RVB, ekspertët mendojnë se AL harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare për mbarëvajtjen institucionale. Ky plan financimi institucional përmban kostot e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, si dhe detyrime të tjera financiare. <i>Megjithatë, GVJ gjykon të nevojshme që institucioni të hartojë raporte financiare si dhe planin për mbështetjen financiare të detajuar për të garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit referuar kohështrijres të këtij programi.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Evidenca 4, 42
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar informacionit në RVB dhe evidences 92, raportimi financiar i UL përmban një pasqyrë financiare të të ardhurave dhe institucioni i nënshtrohet kontrollit të auditimit. <i>Bazuar në këtë kriter, GVJ rekomandon që institucioni, përtej dokumentimit të gjendjes financiare, të vlerësojë edhe efektivitetin financiar të programit, si dhe mundësitë e gjenerimit të të ardhurave nga burime të tjera për të rritur qëndrueshmërinë financiar te programit.</i>

	Evidencat 91, 92			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas RVB dhe takimeve në institucion, raportimet financiare realizohen vetëm në nivel institucional. Evidenca 42			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në pasqyrat financiare, duket se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare, duke pasur parasysh numrin e studentëve dhe të ardhurat në rritje. Nuk ka evidence për ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. <i>GVJ sugjeron të diversifikohen burimet e financimit duke eksploruar mundësi të tjera të ardhurash, p.sh projekte kombëtare/ndërkombëtare, përveç konsulencave dhe tarifave të edukimit. Kjo do të shërbente si garanci për rritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të programit të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>UL garanton mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Statuti UL (Evidenca 3) dhe Rregullorja e programit BAB (Evidenca 10), përcaktojnë procedurat e hyrjes dhe daljes së studentëve në program, si ata mund të regjistrohen, kriteret që duhet të përmbushin, kërkesat mësimore dhe përfundimin me diplomë. Sekretaria mësimore mbikëqyr këtë proces.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e programit, fakultetit dhe institucionit, në zbatim të ligjit të arsimit të lartë, janë një bazë e mirë për të garantuar barazinë e të drejtave të njëjta. Nga vlerësimi nuk lihet të dyshohet për diskriminim ndaj studentëve. Evidenca 3, 10
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Institucioni zbaton udhëzimet e MASR lidhur me kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Bazuar në informacionin e mbledhur gjatë takimeve në institucion, institucioni e plotëson këtë kriter. Evidenca 3, 41, 44
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Nga takimi me Zyrën e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës u konfirmua që institucioni përdorë ditet e karrierës për të bërë publike procedurat dhe kriteret e pranimit. Këto kriteret si edhe kriteret e përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UL, të Fakultetit, të Departamentit dhe të programit të studimit. <i>GVJ sugjeron që politikat dhe procedurat e mësipërme të bëhen publike përmes web-faqes së institucionit.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara çdo fillimi viti akademik, sipas informacionit që GVJ mbledhi gjatë vizitës në institucion, UL njihet e interesuara me programin e studimit që ofron dhe kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për çdo program. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet ditëve të karrierës.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	Vizita në institucion dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion konfirmojnë që UL miraton në fillim të vitit akademik kriteret për

akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Evidenca 3, 41, 44		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Referuar RVB, UL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Evidenca 10, 41		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Sipas RVB, UL harton politika të bursave për student në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Evidenca 67		
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UL e plotëson këtë standard plotësisht. Institucioni ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e programit të studimit përcakton procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Këto informacione jepen gjate javes se pare te orientimit të studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet qe kanë studentët me përgjegjësen e departamentit e cili shërben edhe si koordinatore programit.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregullorja e programit të studimit përcakton procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve. Ky informacion pasqyrohet edhe në fletëpalosjet informuese të UL. U panë dhe u verifikuan disa dosje studentësh të regjistruar në sekretari. Evidenca 10, 67
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Stafi akademi u bën të ditur studentëve që orën e parë të mësimit programin e lëndës si edhe mënyrën e vlerësimit të tyre. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e cdo lënde. Evidenca 10, 21
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e programit BAB, dhe

me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	rregulloren e diplomimit. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës, por gjatë takimeve me studentët, GVJ konstatoi se ata nuk e disponojnë një informacion të tillë lidhur me punimin e diplomës. <i>GVJ rekomandon si më lart lidhur me diplomimin me një temë diplome.</i> Evidenca 10, 37		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Gjithashtu UL është aktiv në rrjetet sociale, News 24 dhe webfaqen e UL, përgatit fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij.		
Konkluzione	<i>GVJ mendon se standard përmbushet kryesisht, dhe rekomandon që institucioni të informojë dhe aplikojë mundësinë e punimit të diplomës.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjate takimeve ne institucion, rezultoi se informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu një informacion i përgjithshëm shfaqet në webfaqen e UL.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës. Evidenca 21
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni nëpërmjet Zyrës së Studenteve dhe Këshillimit të Karrierës informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi. Evidenca 111
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe	Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambientet e Fakultetit të Biznesit, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e universitetit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 45

shërbimet në funksion të realizimit të tij.									
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Gjatë takimeve me stafin akademik grupin e punës por edhe studentet, na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, Moodle, Microsoft-Teams të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike.								
Konkluzione	<i>UL studentët janë të mirëinformuar me përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve për programin e studimit, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të UL.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore institucioni mban të dhëna vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit. Një gjë e tillë u evidentua nga takimi me zyrën e sekretarisë mësimore dhe shqyrtimit të regjistrave të studentëve. Nr i studentëve është si vijon për vitet akademike: 2019-2020: 52 studentë 2020-2021: 53 studentë 2021-2022: 74 studentë 2022-2023: 39 studentë Vihet re një qendrushmëri e numrit të studentëve të këtij programi, me përjashtim të vitit të fundit.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Gjithashtu, UL përdor sistemin elektronik Pitagora. Evidenca 68. 78
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të	Sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore institucioni duhet t'i zotërojë këto të dhëna. Këto të dhëna ruhen në mënyrë rigoroz nga sekretaria

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 46

përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	mësimore. Ato u shqyrtuan gjatë këtij procesi vlerësimi. Sekretaria mësimore dhe institucioni raporton këto të dhëna edhe në MASR.			
	Evidenca 3, 68			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. Departamenti AB bashkepunon me zyrën alumni shkallën e cilësisë së punësimit të tyre.			
	Evidenca 46, 48			
Konkluzione	<i>UL disponon databaze në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Rregullorja e institucionit (neni 9: Komisionet e përhershme në nivel institucioni përbëhen nga jo më pak se katër anëtar, prej të cilëve një është student, i propozuar nga Këshilli Studentor), dhe takimet me studentet, konkludojnë se Kryetari i Këshillit Studentor merr pjesë në Senatin Akademik, NJSB, Këshillin e Etikës (neni 12), dhe studentët kanë përfaqësues në mbledhjet dhe grupin e punës GVB.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<i>Gjate shkrimit të RVB do të ishte mire të jepej informacion specifik duke cituar nenet përkatëse të rregulloreve, sipas kriterëve ku aplikohen.</i> Evidenca 4, 55, 116

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Zyra e NJSBC merret me analizimin e opinioneve të studenteve të mbledhura nepermjet pyetësorëve. Deri tani nuk është bërë ndonjë rishikim kurrikule, por në takime u fol edhe për përfshirjen të alumni në të ardhmen në këtë process.</p> <p>Evidenca 114</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e UL (neni 75), parashikon që studentët kanë të drejtë të shikojnë fletët e vlerësuar të provimeve si dhe të kërkojnë rishikim të vlerësimeve. Sipas RVB, studentët kanë të drejtë të kërkojnë ngritjen e komisionit pranë departamentit. Nderkohe, bazuar ne rregulloren e UL, studentët kanë të drejtë të paraqesin brenda tre ditëve nga marrja dijani e vlerësimit, ankesë me shkrim tek Dekani i fakultetit përkatës. Ankimimi i dërgohet Departamentit përkatës dhe përgjegjësi i I tij ngre një komision ad-hoc vleresimi, jo më vonë se 5 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim.</p> <p><i>GVJ rekomandon që ky proces të përshkruhet me detaje në RVB duke përmendur nenet e rregulloreve përkatëse.</i></p> <p>Evidenca 4, 114, 132</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në UL studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse, këshilluese, etj. duke e plotësuar këtë standart.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UL parashikon në rregulloret e tij informimin e studentëve dhe ju jep të drejtën e organizimit nëpërmjet Këshillit Studentor të parashikuar në rregulloren e UL.</p> <p>Sipas rregullores BAB studentët kanë të drejtë të informohen mbi rezultatet dhe t'i ankojnë ato brenda procedurave të parashikuara.</p> <p>Ndërkohë institucioni mban komunikim të mirë dhe të vazhdueshëm në lidhje me mësimdhënien dhe mundësi të tjera nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës dhe studentit.</p> <p>Evidenca 4, 56</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me</p>	<p>Në UL zyra e studentit dhe këshillimit të karrierës asiston studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe këshillon lidhur me çështjet mësimore, praktikat dhe programin e studimit.</p> <p>Evidenca 4, 56</p>

procesin mësimor dhe programin e studimit.				
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Zyra e Alumni, pjese e zyres së këshillimit të Karrierës është përgjegjëse për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të studentëve pas diplomimit.</p> <p><i>Do ishte me vlerë që krahas RVB të ishte paraqitur një evidencë se si përdoren këto të dhëna nga autoritetet drejtuese, si dhe nëse kryhen organizime për të mbajtur të angazhuar Alumni nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.</i></p> <p>Evidenca 49, 56, 112</p>			
Konkluzione	<i>UL ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, dhe i kushton rëndesi ankimeve e problematikave të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ referuar dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimeve me satfin akademik dhe atë drejtues të programit, konstaton se institucioni ka të hartuar udhëzues për përdorimin e metodave inovatore të mësimdhënies. Gjithashtu bazuar në dokumentacion, evidentohet zhvillimi i një sere trajnimesh dhe manualesh për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien.</p> <p>E 80_Modul trajnimi “Learning assessment and student motivation” E 82_Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin E 5.5 doc shtese _Trajnim Mesimdhënia Online_ Moodle E 5.3 Doc shtese_E 90_Trajnim Udhezues_Metodat Inovative te Mesimdhënies</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur strukturat dhe ka krijuar mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe cilësisë së mësimdhënies. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p>Në nivel institucional përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Monitorimi i sigurimit të cilësisë funksionon edhe në rang fakulteti, kur kjo kërkohet nga dekani ose rregulloret institucionale. Kjo njësi monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor. Procesi mësimor vlerësohet dhe nga studentët.</p> <p>Në vizitën në institucion studentët na bënë me dije se vlerësonin mësimdhënien dhe stafin akademik në mënyrë anonime cdo vit akademik. Këto raporte pasi analizohen shërbejnë si të dhëna të rëndësishme për intervent nëse është e nevojshme. Institucioni gjithashtu ka hartuar manual dhe strategji për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe stafi akademik dhe administrative ishin në dijeni për to. GVJ gjatë takimit me NJBSC evidentoi funksionimin e njësisë dhe varësinë e saj nga rektorati.</p> <p>E 120_Formati i monitorimit te procesit mesimor NJSBC E 121_Manuali NJSBC E 122_Strategjia e NJSBC E 123_Vendim mbi ngritjen e NJSBC E 124_Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar te cilesise ne metodat e mesimdhënies E 125_Politikat e Cilesise UL E 126_Analiza e vleresimit et cilesise_Vleresimi i cilesise Pyetsori i studenteve E 127_Shembull Raporti me komente vlerësimi për pedagogun nga studenti</p>




Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se pyetësi zhvillohet para përfundimit të cdo semestri dhe synon përfshirjen sa më të gjerë të studentëve të programit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj. E 127_Shembull Raporti me komente vlerësimi për pedagogun nga studenti		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ evidentoi bazuar në dokumentacion se strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies bënë publike nëpërmjet një raporti rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies. E 124_Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënies		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Raportet e publikuara në institucion nuk mbetëshin vetëm në terma të përgjithshme të gjetjeve. Në këto raporte identifikohen shembujt dhe praktikave të mira, për promovimin e kulturës së cilësisë. E 124_Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënies		
Konkluzione	<i>GVJ lidhur me këtë standard, është i mendimit se UL, ka një politikë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të mësimdhënies. GVJ rekomandon që analizat e vlerësimit të NJSBC duhet të jenë më specifike dhe detajuar në nivel programesh me një kuorum më të lartë të kampionit përfaqësues (studentët) me qëllim identifikimin e cilësisë së cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar strukturave të sigurimit cilësisë, rezulton se UL, ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL (sipas ligjit 80/2015), Sektorin e Kurrikulës dhe SBC, në nivel IAL, që kryejnë procedurat administrative për monitorimin e cilësisë, organizimin e pyetësorit, përpunimin e tij dhe hartimin e raportit si dhe strukturat e njësive bazë dhe kryesore, të cilat ndjekim monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi. Institucioni ka ngritur strukturat me Vendimin Nr. 12/4 datë 23.12.2016 dhe ka krijuar dhe manual dhe politika për funksionimin e saj. E 121_Manuali NJSBC E 122_Strategjia e NJSBC

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>E 123_Vendim mbi ngritjen e NJSBC</p> <p>NJSBC-ja përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga NJSBC-ja dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu, departamenti përgjegjës për programin dhe Fakulteti i Ekonomisë realizojnë vlerësimin e ecurisë së mbarëvajtjes së programeve të studimit. Për realizimin e vlerësimit përdoren disa metoda si: pyetësorë me studentët, inspektime gjatë orëve të mësimit në auditor nga përgjegjës i departamentit dhe nga përfaqësues të NJSBC-së. Departamenti dhe NJSBC-ja përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme për ecurinë e treguesve të cilësisë si, treguesit për vlerësimin e programit, treguesit për vlerësimin e lëndës, treguesit për vlerësimin e procesit mësimor dhe të pedagogut, tregues për gjendjen e infrastrukturës etj.</p> <p>GVJ evidentoi që në këtë process vlerësimi dhe përmirësimi përfshihen studentët dhe ekspertë të jashtëm.</p> <p>E 123_Vendim mbi ngritjen e NJSBC E 122_Strategjia e NJSBC E 124_Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mesimdhënies</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni UL rezultoi të ketë kryer akreditimin institucional sipas ligjeve në fuqi sikurse dhe akreditime të mëparshme të programeve të tij. Akreditimi i jashtëm është kryer nga ASCAL. Ndërkohë për treguesit e brendshëm të cilësisë dhe për përmirësimin e saj funksionojnë NJSBC sikurse dhe raportet që vijnë nga ekspertët e jashtëm.</p> <p>E 122_Strategjia e NJSBC E 19_Certifikata e Akreditimit Institucional</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mesimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Nga dosja e vlerësimit të brendshëm dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se përdoren disa mekanizma, si monitorim i vazhdueshëm nga njësi bazë/kryesore, sondazhi i studentëve, vëzhgim i paparalajmëruar i metodave të mesimdhënies, si dhe vlerësimi i performancës nga njësi bazë të mesimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Të gjitha këto përdoren si matës dhe monitorues të mesimdhënies dhe kërkimit shkencor. Bazuar në rezultatet e tyre institucioni zhvillon raporte të cilat shërbejnë si një instrument për marrjen e veprimeve dhe vendimeve kur është e nevojshme.</p> <p>E 122_Strategjia e NJSBC E 115_Analiza e pyetësorit të studentëve E 133_Formular Vlerësimi i Studentëve për pedagogun dhe lëndën</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit</p>




	<i>Bachelor në Administrim Biznesi, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm e të jashtëm të sigurimit të cilësisë. GVJ sugjeron që NJBSC duhet të rrisë përbërjen e saj me burimet e nevojshme njerëzore, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë të gjitha objektivat dhe funksionet e saj. GVJ gjithashtu vëren se NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimit të syllabuseve sipas rekomandimit të përmendur (Standardi II.3/Kriteri 4).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>GVJ konstatoi se për të vlerësuar e mbikëqyrur programin e studimit Bachelor në Administrim Biznes UL, përdor mekanizëm formal -sondazhe cdo fund semestri. Me anë të këtyre sondazheve institucioni arrit të bëjë vlerësimin e aspekteve të ndryshme të cilësisë.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimet me përfaqësues të zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezultoi se rezultatet e sondazheve të studentëve dokumentohen dhe analizohen. Pas analizimit të tyre hartohet një raport përmbledhës që përmban analizat e këtyre të dhënave sikurse dhe jepen rekomandime sipas gjetjeve, duke synuar të adresojë problematikat e hasura nga sondazhet nëpërmjet drejtuesit të njësive bazë, të njësive kryesore apo strukturave të tjera që kanë në përgjegjësinë e tyre problematikën e identifikuar. Një mekanizëm tjetër i përdorur, është vlerësimi i performancës së stafit në mënyrë të vazhdueshme, nga njësia bazë, mbështetur në bazën ligjore. Vlerësimi i stafit bëhet nga drejtuesit e njësive bazë. Gjithashtu institucioni nëpërmjet një procesi formal, ka ngritur GVB, që ka hartuar RVB dhe ka përgatitur dosjen e vetëvlerësimit për qëllim akreditimi, dokumentacionit të së cilës, i jemi referuar vazhdimisht si GVJ, gjatë këtij procesi.</p> <p>E 122_ Strategjia e NJBSC E 115_ Analiza e pyetsorit të studentëve E 133_ Formular Vlerësimi i Studentëve për pedagogun dhe lëndën</p>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, RVB përmban një vlerësim për pikat e dobta dhe të forta të programit të studimit. Njëkohësisht dhe në raportet që na janë vënë në dispozicion nga institucioni NJSBC identifikon problematikat e mundshme për të mundësuar marrjen e masave për përmirësimin e tyre.</p> <p>E 115_ Analiza e pyetsorit të studentëve</p>

kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	E 133_Formular Vlerësimi i Studentëve për pedagogun dhe lëndën			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstatoi se në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi, përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, të cilat janë të inkorporuara në seksionet e pyetësorit që plotësojnë studentët për vlerësim.</p> <p>GVJ edhe përgjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët evidentoi lirshmërinë e tyre për vlerësimin e stafit akademik dhe cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>E 133_Formular Vlerësimi i Studentëve për pedagogun dhe lëndën</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit NJBSC përdor metodat e tërthorta dhe analizon rezultatet e tyre.</p> <p>GVJ nuk evidentoi zhvillimin e këtyre sondazheve për të diplomuarit apo dhe nga institucione që bashkëpunojnë.</p> <p><i>Bazuar në këtë GVJ rekomandon shtrirjen e zhvillimit të vlerësimit të mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit dhe në aktorë të tjerë që lidhen me institucionin si rrjeti ALUMNI apo institucione të tjera me të cilat UL ka bashkëpunim.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se UL monitoron dhe vlerëson përmes KSBC, NJSBC, njësisë bazë dhe kryesore, në mënyrë periodike programin e studimit, Bachelor në Administrim Biznes, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Pavarësisht për sa më sipër, GVJ sugjeron që IAL të përfshijë më shumë mekanizma të diversifikuar të drejtpërdrejta dhe të tërthortë në vlerësimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi sikurse dhe më shumë aktorë të ndërlidhur me institucionin, si edhe NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimin të syllabuseve të programit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ evidentoi që NJBSC përbëhet nga pesë anëtarë. Në përbërje të saj kjo njësi ka një student dhe një ekspert të jashtëm duke mundësuar në këtë mënyrë një përfshirje të aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Diversifikimi i njësisë dhe përfshirja e aktorëve të jashtëm mundëson përmirësimin e vazhduar të cilësisë duke parë dhe nën optikën e faktorit jashtë institucionit. E 123_Vendim mbi ngritjen e NJSBC
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni për të zhvilluar mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit ka mundësuar hartimin e manualeve dhe strategjive të NJBSC. Ky manual shërben si një guidë për funksionimin e njësisë. Vetë NJSBC ka një procedurë të përcaktuar të funksionimit të saj. Kjo njësi bazuar në dolumentacion ushtron funksionin e saj si një njësi autonome dhe me akses të plotë në të dhënat e institucionit. E 123_Vendim mbi ngritjen e NJSBC E 121_Manuali NJSBC E 122_Strategjia e NJBSC
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në takimin me NJBSC evidentoi përfshirjen në këtë njësi për vlerësimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznes antar nga njësia bazë dhe kryesore e këtij programi studimi. Gjithashtu bazuar në dokumentacion në këtë njësi është përfshirë një student dhe një ekspert I jashtëm. Tre antarët e tjerë në NJBSC janë staf akademik me kohë të plotë në UL. Përfshirja e të gjitha palëve krijon mundësinë e sjelljes së këndvështrimeve të ndryshme dhe adresimin e çështjeve që janë me interes të gjerë për cilësinë e programit Bachelor në Administrim Biznes, si për stafin akademik, studentët dhe UL në tërësi. E 123_Vendim mbi ngritjen e NJSBC
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ evidentoi që procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të NJBSC janë transparente dhe në zbatim të Statutit dhe rregulloreve të institucionit. Gjithashtu edhe në takimin me studentët evidentuam që pyetsorët që zhvillon kjo njësi ruajnë konfidencialitetin dhe anonimatit të studentëve të cilët marrin pjesë në sondazhe. Ky proces i ndjekur në këtë mënyrë bën të mundur shmangien e diskriminimit dhe pabarazisë kundrejt grupeve të interesit. Gjithashtu ruajtja e anonimatit dhe konfidencialiteti i të dhënave garantojnë respektimin e integritetit të aktorëve të përfshirë në vlerësim apo aktorëve vlerësues. E 3_Statut UL E 121_Manuali NJSBC




	E 122_Strategjia e NJBSC			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në dokumentacionin e vënë në dispozicion për GVJ, në NJBSC një nga anëtarët është ekspert i jashtëm duke mundur në këtë mënyrë një përfshirje të aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Përfshirja e aktorëve të jashtëm mundëson diversifikimin e njësisë sikurse dhe mundëson përmirësimin e vazhduar të cilësisë duke parë dhe nën optikën e faktorit jashtë institucionit.			
Konkluzione	E 123_Vendim mbi ngritjen e NJSBC			
	<i>GVJ është e mendimit se UL përfshin të gjithë aktorët e brendshëm, staf akademik, njësi kryesore, bazë, KSBC dhe NJSBC, në sigurimin e cilësisë. Në këto struktura ka përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm. Raporti që përgatiten nga NJBSC publikohen dhe janë transparente, por GVJ sugjron që këto raporte të hartohen në mënyrë periodike (cdo fundsemestër/vit akademik) dhe të përdoren këto të dhëna për të adresuar problematikat e identifikuar dhe për të replikuar praktikatat e mira.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion evidentoi se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. E 122_Strategjia e NJBSC
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ evidentoi që në faqen zyrtare të institucionit raporti i fundit i publikuar ishte ai i vitit 2018. Në faqen zyrtare ishin të publikuara dhe transparente manuali dhe strategjia e NJBSC dhe statuti i institucionit. <i>GVJ rekomandon institucionin të përditësojë raportet në faqen zyrtare të institucionit për të qënë transparent me aktorët e interesuar dhe për ti pajisur ato me informacionin që u nevojitet.</i> https://luarasi-univ.edu.al/sq/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë	Raportet të cilat dalin mbas analizimit të të dhënave në lidhje me cilësinë e programit të studimit përmbajnë dhe rekomandimet dhe hapat që duhet të ndërmerren. GVJ ju bë me dije përgjatë vizitës që bazuar në këto




përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	raporte institucioni ka ndërmarrë masa për ër mirësimin e mësimdhënies duke organizuar trajnime të ndryshme. Ky informacion gjendet i detajuar, së bashku me trajnimet e krijuara, dhe në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe në dokumentat e tjerë të vënë në dispozicion. E 130_Raporti Vjetor 2020-2021			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm, Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, raporton në mënyrë të vazhdueshme në rektorat, për rezultatet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në këtë raportim cilën adresohen edhe rekomandime mbi gjetjet e sondazhit të studentëve. Më pas këto gjetje raportohen dhe iskutohen dhe në instance të tjera të cilat lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me to sic është dhe Fakulteti dhe Departamenti. E 3_Statut UL E 121_Manuali NJSBC			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Përgjatë vizitës në institucion GVJ ju bë me dije se institucioni organizon në mënyrë periodike në fakultet apo departamente veprimtari për informimin e stafit akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë. GVJ ju bë me dije se përgjatë këtyre veprimtarive periodike stafet akademike në departamente diskutojnë dhe për përmirësimin e cilësisë në terma afatmesëm dhe afatgjatë për programet e studimit që ato mbulojnë. Bazuar në këto përmirësimi stafet akademike kanë zhvilluar trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. E 82_Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin E 5.3 Doc shtese E 90_Trajnim Udhezues_Metodat Inovative te Mesimdhënies E 5.4 Doc shtese F. 100_Trajnim_Metoda Moderne Mesimdhënieje_NJSBC			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion evidentoi se proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi, janë kryesisht publike por duhet të jenë edhe më shumë transparente dhe të synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznes” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luarasi”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Infrastruktura dhe vendndodhja e institucionit.
2. Mbështetja institucionale e studentëve dhe fryma pozitive e krijuar nga departamenti AB dhe drejtuesja e tij jep ndikim pozitiv në mbarëvajtjen e procesit mësimor, informimit dhe shprehjen e mendimit të lirë nga studentët.
3. Institucioni ndjek një politikë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të mësimdhënies.

Pika të dobta:

1. Programi i jep një peshë të madhe lëndëve të profilit financiar, në masën 40 ECT, bazuar në kurrikulën e programit (tabela 9), përkundrajt 48 ECTS lëndë të profilit menaxhim, ndërkohë që UL ofron një program tjetër bachelor në financë. Po ashtu, kategoria C e lëndëve me zgjedhje nuk i ofrohet studentëve. **(Standardi II.4)**
2. Ngarkesa mësimore në program nuk plotëson detyrimin ku të paktën 70% e orëve të programit duhet të mbulohet nga personel akademik PAE. **(Standardi IV.1)**
3. Kontratat paraqesin parregullsi si vijon:
 - a. ka kontrata pune me afat të pacaktuar për stafin akademik Msc,
 - b. nuk përcaktojnë ngarkesën mësimore,
 - c. për stafin PAK nuk ka leje angazhimi nga qendra e tyre e punës **(Standardi IV.1, kriteri 6)**
4. Syllabuset e programit BAB (Evidenca 21) paraqesin mangësi në disa elementë kryesorë si: paraqitja e tipologjisë sipas gjurmimit dhe në pëprthje më Planin Mësimor të Miratuar; mungesa e titullarit të lëndës: mungesa e shpjegimit të çdo teme sipas javëve të shpërndarjes tematike shoqëruar me literaturën përkatëse të detajuar me faqe dhe mungesa e literaturës së detyrueshme e përditësuar me botime të 5 viteve të fundit. **(Standardi II.3)**
5. Pjesëmarrje e ulët në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare Përfshirje e ulët e personelit akademik dhe mungesë e përfshirjes së studentëve në aktivitete dhe botime shkencore. Mungesa e një plan-buxheti të detajuar me zërat specifik për mbështetjen e trajnimeve dhe kriteret e financimit për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, si dhe mungesa e një procedure transparente për alokimin e fondeve për kërkimin shkencor **(Standardi III.4)**.
6. Numër i kufizuar dhe i papërditësuar i fondit fizik të bibliotekës, rekomandim ky i akreditimit të mëparshëm. **(Standardi IV.3)**.

Rekomandime:

1. Të bëhet rishikimi i kurrikulës për të siguruar se është i përditësuar me zhvillimet e fundit në tregun e punës. Gjithashtu, të konsiderohet raporti i lëndëve të menaxhimit/financës në favor të atyre të profilit të menaxhimit dhe të shikohen mundësi të futjes së lëndëve të tjera më të vlefshme për menaxherë dhe administrim biznesi si psh. Biznes Elektronik, apo Tregeti Eektronike, etj. Të zbatohet kategoria C e lëndëve me zgjedhje duke iu ofruar studentëve mundësi zgjedhje nga një gamë e gjerë lëndësh. Të merren masa për zbatimin e rregullores së diplomimit dhe ofrimin e mundësisë së përmbylljes së studimeve edhe nëpërmjet punimit të diplomave krahas provimit të përgjithshëm.
2. Të merren masa për përmbushjen e detyrimit ligjor lidhur me ngarkesat mësimore në programin e studimit, ku të paktën 70% e orëve të programit duhet të mbulohet nga personel akademik PAE. Të përpilohen kontratat për të reflektuar parregullsitë e evidentuara lidhur me afatin e tyre sipas titullit akademik për stafin akademik Msc, të përcaktojnë ngarkesën mësimore. Për stafin PAK të depozitohet leje angazhimi nga qendra e tyre e punës.
3. Të përditësohet literatura për programin BAB me botime të pesë viteve të fundit dhe shtohet numri i kopjeve fizike në bibliotekë.
4. Të rritet mbështetja për stafin akademik dhe studentët për pjesëmarrje në projekte dhe kërkim shkencor ndërkombëtar si dhe për botime shkencore në revista prestigjioze ndërkombëtare me faktor impakti. Gjithashtu, rekomandohet të përcaktohen kriteret e financimit për aktivitete kërkimore/shkencore si dhe procedure transparente për alokimin e fondeve për kërkimin shkencor.
5. NJSBC duhet të rrisë përbërjen e saj me burimet e nevojshme njerëzore, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë të gjitha objektivat dhe funksionet e saj. NJSBC të integrojë ne raportin e saj vjetor edhe raportet vjetore për program studimi.
6. Të standartizohen dhe përditësohen Syllabuset e programit të studimit BAB në përmbushje të kriterëve sipas VKM 41/2018 e ndryshuar, duke vendosur titullarin e lëndës, tipologjia, shpërndarja e temave me literaturën përkatëse me nr. faqesh, perditësimi i literaturës detyruese).
7. Duhet ndërtuar urat e bashkëpunimit me industrinë, biznesin dhe aktorë të tjerë homolog dhe duhet gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikant/intershipet e tyre, por dhe projektet e përbashkëta, mbështetjen e ideve dhe stratupeve të reja, patentim, etj.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Business Administration" provided by the Higher Education Institution University "Luarasi"

Strengths and affirmations:

1. Infrastructure and location of the institution.
2. The institutional support of students and the positive energy created by the AB department and its leader gives a positive impact on the progress of the learning process, information and the expression of free opinion by students.
3. The institution follows a policy for guaranteeing and promoting the quality of teaching and draft special guidelines for the development of teaching methods and monitoring.


Weaknesses:

1. The program gives a big weight to the subjects of the financial profile, to the extent of 40 ECTS, based on the program curriculum (table 9), compared to 48 ECTS for the management profile subjects, while UL offers another bachelor's program in finance. Also, category C of elective courses is not offered to students.
2. The teaching load in the program does not meet the obligation where at least 70% of the hours of the program must be covered by PAE academic staff.
3. The contracts present irregularities as follows:
 - a. there are open-ended employment contracts for Master of Science academic staff,
 - b. the teaching load sometimes is not defined,
 - c. for academic staff with contract (PAK) sometimes the engagement permit from their work center is missing
4. The syllabuses of the BAB program (Evidence 21) present deficiencies in some main elements such as: the presentation of the typology according to the excavation and in accordance with the Approved Curriculum; lack of subject title: lack of explanation of each topic according to weeks of thematic distribution accompanied by relevant literature detailed with pages and lack of mandatory literature updated with publications of the last 5 years.
5. Low participation in national and international projects. Low involvement of academic staff and lack of involvement of students in scientific activities and publications. Lack of a detailed budget plan with specific items for training support and funding criteria for research/scientific activities for the professional development of academic staff, as well as the lack of a transparent procedure for the allocation of funds for scientific research.
6. Limited and non-updated number of the library's physical fund (which was a recommendation of the previous accreditation as well).



Recommendation:

1. Review the curriculum to ensure it is up to date with the latest developments in the labor market. Also, consider the ratio of management/finance subjects in favor of those of the management profile and look at the possibility of introducing other more valuable subjects for managers and business administration, such as E-Business, or E-Commerce, etc. Implement category C of elective courses, offering students the opportunity to choose from a wide range of courses. To take measures for the implementation of the graduation regulation and offer the possibility of completing the studies also through the work of the diplomas in addition to the general exam.
2. To take measures to fulfill the legal obligation regarding the teaching loads in the study program, where at least 70% of the hours of the program must be covered by PAE academic staff. To design the contracts to reflect the irregularities identified regarding their term according to the academic title for the MSc academic staff, to determine the teaching load. For PAK staff, a work permit must be submitted from their work center.
3. To update the literature for the BAB program with publications of the last five years and increase the number of physical copies in the library.
4. To increase support for academic staff and students for participation in projects and international scientific research as well as for scientific publications in prestigious international journals with an impact factor. Also, it is recommended to define the funding criteria for research/scientific activities as well as a transparent procedure for the allocation of funds for scientific research.
5. NJBSC should increase its composition with the necessary human resources so that it is able to implement all its objectives and functions. NJSBC to integrate in its annual report the annual reports for the study program.
6. To standardize and update the Syllabus of the BAB study program in fulfillment of the criteria according to VKM 41/2018 as amended, establishing the title of the subject, the typology, and the distribution of topics with the relevant literature with no. pages, updating binding literature).
7. Bridges of cooperation with industry, business, and other homologous actors must be built and ways must be found that enable not only the employment of students and their internships/internships but also joint projects, support of new ideas and startups, patenting, etc.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

